

**VENDIM**  
**Nr.214, datë 21.2.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “BISHNICA 2”, DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË  
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23 pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Bishnica 2” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Titan” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Bishnica 2” të kërkojë shprehje interesi dhe të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**